

VENDIM
Nr. 274 , datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.477, DATË 25.7.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT DHE MASËN E TRAJTIMIT TË VEÇANTË
FINANCIAR TË PILOTËVE DHE TEKNIKËVE FLUTURUES ME HELIKOPTER, NË
PENSION, NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETËTIT DHE
GARDËN E REPUBLIKËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 3 e 8 të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr.477, datë 25.7.2012, të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Punonjësi i Policisë së Shtetit dhe i Gardës së Republikës, në funksionet pilot dhe teknik fluturues të helikopterëve, që trajtohen nga ligji nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, me daljen në pension, plotëson kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj